



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.30/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj– kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Faton Idrizaj anëtar në Komisionin Zgjedhor në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Mynih, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të parregullsisë në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZP.Anr.30/2026, e datës 08.06.2026, e parashtruar nga Faton Idrizaj anëtar në Komisionin Zgjedhor në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Mynih, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet procedurë hetimore në lidhje me votimet me kusht, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 08.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.30/2026 nga Faton Idrizaj anëtar në Komisionin Zgjedhor në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Mynih, në të cilën thekson se gjatë procesit të votimit me kusht në Qendrën e Votimit DE05-03 në Mynih ka vërejtur parregullsi, ashtu që me datën 06 Qershor 2026, rreth orës 18:00, gjatë monitorimit të procesit zgjedhor ka konstatuar zhvillimin e katër rasteve të votimit me kusht, që lidhen me personat Jeton Maliqi-me vendbanim në Kosovë, Mimoza Haziri me vendbanim të përhershëm në Gjermani e punësuar në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Mynih, Fatmir Qufaj me vendbanim të përhershëm në Gjermani, kryesues i Komisionit Zgjedhor në vendvotimin nr.3, Albion Hoti anëtar i Komisionit Zgjedhor në të njëjtën Qendër të Votimit. Nga rrethanat e konstatuara në vendvotim, ekzistojnë dyshime të bazuara se mund të mos jenë përmbushur kriteret ligjore për ushtrimin e drejtës së votimit me kusht, veçanërisht në rastet e personave me vendbanim të përhershëm jashtë Republikës së Kosovës. Po ashtu është pretenduar se lejimi i këtyre rasteve të votimit është mbështetur në një marrëveshje apo autorizim të brendshëm ndërmjet përfaqësuesve të Konsullatës dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjë që kërkon verifikim të plotë juridik dhe institucional. Gjithashtu kërkohet sqarim i veçantë lidhur me ushtrimin e funksioneve të dyfishta institucionale, përkatësisht rolin e Konsullit të Përgjithshëm, Afrim Nura, në cilësinë e menaxherit të qendrës së votimit, në raport me parimet e paanshmërisë dhe ndarjes së funksioneve zgjedhore. Tutje ka

theksuar se për mbështetje të kësaj ankese ka në posedim dokumentacionin fotografik të katër zarfeve të votimit me kusht, të cilat është gatshëm ti paraqes para organit hetues. Ka kërkuar nga PZAP që ta pranoj ankesën si të bazuar dhe të iniciohet procedurë e plotë hetimore, të verifikohet ligjshmëria e të gjitha rasteve të votimit me kusht në qendrën e lartcekur, të hetohet baza juridike e çdo autorizimi apo marrëveshje të pretenduar, të sigurohen dhe administrohen provat relevante, të ndërmerren masat ligjore dhe administrative në rast të konstatimit të shkeljeve.

Ankesës i ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit dhe fotografi.

Në përgjigje në ankesë ZP.Anr.30/2026, KQZ kanë theksuar se procesi i votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës realizohet në përputhje me nenin 95 dhe 96 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe dispozitat e Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, e cila përcakton kushtet, procedurat e regjistrimit dhe mënyrën e ushtrimit të së drejtës së votës nga shtetasit e Kosovës që ndodhen jashtë vendit. Periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës ka filluar më 6 maj 2026 dhe ka përfunduar më 17 maj 2026. Shtetasit me të drejtë vote që jetojnë jashtë Kosovës kanë mundur të aplikojnë për regjistrim si votues jashtë Kosovës përmes platformës elektronike diaspora.kqz-ks.org, si dhe duke dërguar kërkesën për regjistrim përmes postës në kutinë postare të KQZ-së në Prishtinë. Lista Votuese për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, është certifikuar nga KQZ më 21 maj 2026 (vendimi nr. 01/925/2026). Afati për subjektet politike për dorëzimin e propozimeve për anëtarë të KVV-ve në Përfaqësitë Diplomatike ka qenë nga data 15.05.2026 deri më 26.05.2026. KQZ ka emëruar anëtarët e KVV-së dhe stafin tjetër që kanë shërbyer në Misionet Diplomatike më datë 29 maj, 2 qershor dhe 5 qershor. Neni 95, paragrafi 5, i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton se KQZ-ja i vendos anëtarët e këshillave të votimit në listën e votuesve në qendrën ku shërbejnë, nëse ata nuk janë në listën e votuesve të së njëjtës qendër votimi. Andaj, duke marrë për bazë rrethanat se zgjedhjet e parakohshme mbahen brenda afateve shumë të shkurtra kohore, ka qenë e pamundur që anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve dhe Stafit asistues në Përfaqësitë Diplomatike të emërohen dhe të caktohen në ato qendra para certifikimit të Listës Votuese. Për rrjedhojë, KQZ i ka udhëzuar që, në rastet kur të njëjtit nuk janë regjistruar për votim në Përfaqësi Diplomatike, të evidentohen/nënshkruhen në librin e votimit dhe të votojnë me kusht në ato qendra, duke i vendosur fletëvotimet në zarfe përkatëse dhe jashtë kutisë së votimit. Pas skanimit të listave votuese brenda Kosovës, KQZ do të evidentojë se a ka pasur votim të dyfishtë dhe në rast se jo, zarfet do të procedohen për numërim.

Përgjigjes në ankesë i kanë bashkangjitur vendimet si në vijim: Vendimin Nr. 01/925/2026, të datës 21 maj 2026; Vendimin Nr.01/1067-2026, të datës 29 maj 2026;Vendimin Nr. 01/1068-2026, të datës 29 maj 2026, Vendimin Nr. 01/1069-2026, të datës 29 maj 2026 ;Vendimin Nr. 01/1180-2026, të datës 2 qershor 2026;Vendimin Nr. 01/1235-2026, të datës 5 qershor 2026.

Paneli pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesë, përgjigjes së KQZ-së dhe shkresave të lëndës, vlerësoj se:

-Ankesa është e pas afatshme

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 08.06.2026, me të cilën ka kërkuar që të zhvillohet procedurë hetimore për votimet me kusht në Qendrën e Votimit DE05-03, në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Mynih.

Paneli ka vlerësuar se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 të LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Në të vërtetë ankuesi me datën 08.06.2026 në ora 19:43 ka parashtruar ankesë në emailin e PZAP-së duke mos parashtruar në mënyrë adekuate ankesën ashtu siç parashihet me nenin 6 paragrafi 3 i Rregullores nr.01/2025 për procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesës, për çka PZAP me email e ka udhëzuar lidhur me formën zyrtare të parashtrimit të ankesës, ashtu që ankuesi Faton Idrizaj ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 08.06.2026, në ora 22:59, ndërsa shkelja e supozuar sipas ankuesit ka ndodhur me datën 06.06.2026 në ora 18:00, në këto rrethana paneli vlerësoj se edhe ankesa jo formale e parashtruar nga ankuesi me datën 08.06.2026 në ora 19:43, edhe ankesa e parashtruar në formën adekuate me date 08.06.2026 në ora 22:59 janë paraqitur pas afatit ligjor, pra pas afatit prej 48 orëve për parashtrimin e ankesës.

PZAP sqaron se e drejta e ushtrimit të mjetit juridik është e kushtëzuar me respektimin e afateve të përcaktuara nga ligji, ankesa e paraqitur pas afatit nuk mund të merret në shqyrtim meritore sepse afati për ushtrimin e ankesës është afati prekluziv dhe humbja e tij sjell humbjen e të drejtës së ankimit. Andaj Paneli ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Faton Idrizaj anëtar në Komisionin Zgjedhor në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Mynih, është e pasafatshme duke u mbështetur në dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, ku parashihet që “Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”.

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”. PZAP-i vendosi që të hedhë ankesën e ankuesit si të pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 118 paragrafi 1 dhe 119 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.Anr.30/2025, datë 11.06.2026

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshillë Juridike; kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.